



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Qeveria -Vlada-Government  
Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice  
Departamenti për Profesione të Lira-Departmant Slobodnih Profesija- Department of Free

Komisioni Disiplinor/Disiplinska Komisija/The Disciplinary Comitee

DPL.nr.12/2022

**KOMISIONI DISIPLINOR PËR PËRMBARUESIT PRIVAT**, në përbërje nga Manushe Karaçi kryesuese, Adnan Konushevci dhe Rushit Hoxha, anëtarë të komisionit disiplinor për përmbarduesit privat, në çështjen disiplinore ndaj përmbardueses private, si organ përmbardues, i emëruar nga Ministria e Drejtësisë e Republikës së Kosovës për Territorin e Gjykatës Themelore në , lidhur me veprimet përmbardimore në lëndën përmbardimore, P. nr. 826/2019, pas mbajtjes së seancës dëgjimore publike, në të cilën ka prezantuar përfaqësuesja e Ministrisë së Drejtësisë - Departamenti për Profesione të Lira - Divizioni për Noterinë dhe Përmbardimin Privat, Fadilete Hoxha-Blakqori, pala ankuese nga komuna e me vendbanim në të cilën sipas autorizimit e përfaqëson avokat nga rruga , nr. /në praninë e përfaqësuesit të palës ankuese dhe në mungesë të përmbardueses private të ftuar më rregull për seancë, me dt 14.07.2022, me shumicë votash, mori këtë:

### V E N D I M

Organi përmbardues - Përmbarduesja Private si organ përmbardues, e emëruar nga Ministria e Drejtësisë së Republikës së Kosovës për Territorin e Gjykatës Themelore në është përgjegjëse për shkelje disiplinore pasi që gjatë kryerjes së veprimeve përmbardimore në kuadër të aktivitetit të saj, përmbarduesja private nuk iu ka përmbajtur ligjit, në lëndën me P.nr. 826/2019, i shqiptohet masa disiplinore, shkarkim nga detyra.  
Vendimi hyn fuqi nga dita kur bëhet i formës së prerë.

### A r s y e t i m

*Pretendimet e palës ankuese.*

Pala ankuese, përmes përfaqësuesit të tij, ka paraqitur ankesë me dt 21.04.2022, në Ministrinë e Drejtësisë, Departamentin për Profesione të Lira – Divizioni për Noteri dhe Përmbardim

Privat, ka deklaruar se Përmbauesja Private, ka bërë shkelje procedurale me rastin e lejimit të urdhrin përmbauesje sepe e njëjta e ka lejuar urdhrin në bazë të faturës 07/19 të dt.19.09.2019, pa u plotësuar kushtet ligjore në kuptim të nenit 30 të Ligjit të Procedurës Përmbauesje (LPP), me të cilin urdhër nuk është njoftuar pala ankuese-debitori në atë procedurë. Mëtej pala ankuese pretendon se në kuptim të nenit 110 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), urdhri përmbauesje e më pas konkluzioni i nxjerrë nga përmbauesja private është dashtë t'i dorëzohen personalisht palës ankuese apo përfaqësuesit të tij me autorizim. Pala ankuese poashtu ka theksuar se përmbauesja private e ka caktuar seancën e parë të ankandit publik, pa qenë fare në dijeni pala ankuese – si debitor, që ndaj tij është duke u zhvilluar një procedurë përmbauesje, me çka pala ankuese pretendon se me veprimet përmbauesje të përmbaueses private është dëmtuar me këtë procedurë ose ndalesën që iu është bërë palës ankuese në paluajtshmërinë e tij e ka kuptuar me datë 30 mars 2022, kur pala ankuese ka ardhur në Kosovë dhe ka shkuar në komunën përkatëse, për t'a nxjerrë listën poseduese të shtëpisë së tij dhe meqenëse ishte në procedurë pala ankuese ,nuk ka mundur që t'a nxjerr listën poseduese. I ka propozuar komisionit që të aprovohet ankesa, pasi që përmbauesja private është përsëritëse e shkeljeve përmbauesje ashtu që të njëjtës t'i merret licenca e përmbauesit.

#### *Raporti për fillimin e Procedurës Disiplinore nga Ministria e Drejtësisë.*

Ministria e Drejtësisë, Departamenti për Profesionet e Lira - Divizioni për Noterinë dhe Përmbauesjen Privat, me dt.06.05.2022, ka paraqitur në Komision Disiplinor Raportin Përfundimtar, ndaj përmbaueses private, si organ përmbaues, lidhur me veprimet e ndërmarra nga përmbauesja private, në lëndën përmbauesje P. nr 826/2019. me propozim për komisionin që përmbaueses private t'i shqiptohet masë disiplinore.

Komisioni me dt.14.07.2022 ka caktuar seancë dëgjimore për shqyrtimin e ankesës së palës ankuese në këtë rast,por përmbauesja private, nuk ka prezantuar edhepe e njëjta ishte ftuar me rregull për seancë, siç konstatohet nga posta elektronike e datës 20.06.2022, dhe mungesën e saj nuk e ka arsyetuar, prandaj komisioni bazuar në nenin 423 paragrafi 4 të LPK, seancën dëgjimore e mbajti në mungesë të përmbaueses private, të ftuar me rregull.

#### *Pretendimet e Përmbaueses Private.*

Përmbauesja private, në përgjigjen në ankesë-kërkesë për iniciimin e procedurës disiplinore, e kundërshtoi në tërësi ankesën e palës ankuese si të pabazë, ngase e njëjta është e parashkruar në kuptim të nenit 375 të LPP-së, në të cilën dispozitë ligjore është përcaktuar afati ligjor që procedura disiplinore fillohet brenda 6 muajve nga dita e shkeljes së kryer, por jo më vonë se 1( një) vit nga dita e shkeljes. Përmbauesja më tej ka theksuar se është i paqëndrueshëm pretendimi i palës



ankuese për mosdorëzimin e urdhrin, se është i pa bazuar, ngase kjo ka ndodhur me dt.27.12.2019, kur e ka pranuar urdhrin , i cili është dhëndërrri i palës ankuese. Prandaj në këtë rast nuk kemi shkelje të nenit 110 të LPK-së, siç pretendon ankuesja ngase në mënyrë të qartë rezulton fakti se propozimi për fillimin e procedurës disiplinore është paraqitur pas kalimit të të gjitha afateve ligjore, për arsye se shkelja e nenit 110 të LPK-së, siç pretendohet, ka ndodhur me datë 27.12.2019, ndërsa propozimi për fillimin e procedurës disiplinore është paraqitur me datë 21.04.2022, pra pasi kanë kaluar 2 vite e 4 muaj, nga momenti i shkeljes së pretenduar. Sipas përmbaueses private edhe sikur të ishte paraqitur brenda afatit ligjor propozimi për fillimin e procedurës disiplinore, i njëjti do ishte i pabazuar për faktin se përmes dorëzimit të urdhrin për përbarim tek , nuk është shkelur neni 110 i LPK-së, sepse i njëjti është pajtuar me pranimin e parashtresës - urdhrin për përbarim të datës 27.12.2019 dhe dorëzimi i kryer në këtë mënyrë konsiderohet i rregullt, konform nenit 111 të LPK-së. Përmbauesja private poashtu ka theksuar se ka vazhduar me procedurën përbarimore në këtë rast, pasi që urdhri ishte pranuar nga dhëndërrri i palës ankuese, mirëpo i njëjti pas tri ditësh me datë 31.12.2019, nëpërmjet një parashtrese dërguar Përmbaueses Private, e kishte kthyer mbrapsht Urdhrin Përbarimor P.nr.826/19 të datës 27.12.2019 , edhepse - dhëndërrri i tij, ka theksuar se nuk e njeh palën ankuese. Pasi është bërë i pambarueshëm urdhri për përbarim, është nxjerrë konkluzioni për shitje, P.nr.826/19 me dt. 04.11.2021, si dhe përmes këtij konkluzioni është caktuar seanca e parë e ankandit publik për shitje për datën 06.12.2021 në ora 10:00. Është provuar që konkluzionin për shitje t'i dorëzohet debitorit-palës ankuese , mirëpo fletë dërgesa është kthyer me shënimin që "*me 12.11.2021 dera është e mbyllur...*". Seanca e parë ankandit publik ishte caktuar paraprakisht me konkluzionin e lartcekur, me datë 06.12.2021, në këtë seancë vetëm është evidentuar prezenca e palëve, dhe është konstatuar se nuk ka kushte për mbajtjen e seancës së parë të ankandit publik dhe është nxjerrë urdhër: "*Shtyhet seanca e parë e ankandit publik deri në një afat të pacaktuar, deri kur të sigurohet adresa e saktë e debitorit për dërgimin e shkresës dhe pastaj do të njoftohemi nga kreditori për vazhdimin e seancës së parë të ankandit publik verbal*". Nga kjo përmbauesja private pretendon se nuk e ka konsumuar asnjë shkelje disiplinore për faktin se seanca e parë e ankandit publik është shtyrë në një afat të pacaktuar derisa të sigurohet adresa e saktë e debitorit-palës ankuese. Pretendimi i palës ankuese se përmes propozimit për fillimin e procedurës përbarimore, sipas nenit 30 par. 2 të LPP-së, është konstatuar se fatura në bazë të së cilës është aprovuar urdhri përbarimor, nuk e përmban asnjë element të dokumentit të besueshëm dhe nuk është nënshkruar nga debitori. Ndërsa , sipas përmbaueses private me nenin 29, par.1, nënpar.1.3 të LPP-së, në mesin e dokumenteve të besueshme përcaktohet edhe fatura si dokument i besueshëm mbi bazën e të cilit lejohet përbarimi, ndërsa në par.3 të nenit të njëjtë përcaktohet se dokumenti i besueshëm duhet të përmbajë kreditorin dhe debitorin, si dhe objektin, llojin, shumën dhe kohën

e përmbushjes së detyrimit monetar për t'u konsideruar i përshtatshëm për përbarim. Si kusht esencial që fatura të konsiderohet dokument i besueshëm, është fakti që në faturë të tregohet edhe koha e përmbushjes, e që në rastin konkret përcaktohet afati apo periudha kohore prej tre ditësh, element ky i përcaktuar në faturën e datës 19.09.2019, me numër 07/19 të lëshuar nga kreditorja \_\_\_\_\_ ndërsa shuma që duhet realizuar; kusht tjetër i domosdoshëm, është shuma totale prej 4.498.50 euro. Sipas përbarueses private mungesa e nënshkrimit të debitorit në faturën lëndore, nuk e mundëson apo pamundëson që një faturë të jetë dokument i besueshëm, ngase një kusht i tillë nuk kërkohet me nenin 29 të LPP-së. I ka propozuar Komisionit Disiplinor, që të refuzohet ankesa e palës ankuese si e pabazuar.

*Konstatimet e Komisionit Disiplinor lidhur me shkeljen disiplinore nga përbaruesja private.*

Komisioni Disiplinor me kujdes, vëmendje të veçantë dhe në mënyrë shteruese ka çmuar çdo provë të administruar në seancën dëgjimore veç e veç dhe të gjitha ato së bashku dhe pas analizimit, vlerësimit dhe peshimit të tyre, erdhi në përfundim se përbaruesja private, ka kryer shkelje disiplinore, për arsyet në vijim:

Komisioni vlerëson se shkelja e parë e përbarueses private në këtë rast, është me rastin e inicimit të procedurës së përbarimit në bazë të faturës së datës 19.09.2019, me numër 07/19, e lëshuar nga kreditorja \_\_\_\_\_, sepse fatura jo pse nuk ishte e nënshkruar nga debitori-pala ankuese, por në shkresat e lëndës nuk gjendet asnjë provë shkresore që ndonjëherë është njoftuar paraprakisht pala ankuese me detyrimet që pretendohet se i ka pala ankuese në raport me kreditoren e që kanë të bëjnë me shërbimet të kryera nga kreditorja, në mënyrë që t'i jepet mundësia palës ankuese-debitorit që eventualisht në mënyrë vullnetare t'a përmbushë detyrimin. Nga kjo rezulton që në fillim të procedurës përbaruesja private e ka shkelur afati partitiv për përmbushje vullnetare, andaj pretendimi i përbarueses private se mos nënshkrimi i faturës nuk e pamundëson lejimin e përbarimit, është i paqëndrueshëm.

Komisioni vlerëson se shkelja e dytë e përbarueses private në këtë rast, është me rastin e tentimit të dërgimit të urdhrin palës ankuese në shtetin e \_\_\_\_\_, ku është duke jetuar siç konstatohet nga fletë kthesa postare e datës 19.09.2019, me të cilën pala ankuese nuk është njoftuar asnjëherë. Në këtë rast përbaruesja private ka tentuar që urdhrin përbarimor t'ia dërgon palës ankuese drejtpërsëdrejti duke e anashkaluar procedurën përmes Ministrisë së Drejtësisë – Departamentit për Ndihmë Juridike Ndërkombëtare, përmes të cilit departament edhe zhvillohet procedura me palët në procedurë kur janë duke jetuar jashtë Republikës së Kosovës. Me këtë rast përbaruesja fillimisht është dashtë të paraqes një kërkesë në Ministrinë e Drejtësisë, me të dhënat për palën ankuese siç është adresa e banimit, dokumentin që do ta dërgon dhe së bashku me to edhe një lutje



për Gjykatën Kompetente apo ndonjë institucioni tjetër përgjegjës në shtetin e \_\_\_\_\_, dhe të njëjtat ishte dashur që të jenë të përkthyer në gjuhën që flitet, në vendin ku është duke jetuar pala ankuese. Kjo mënyrë procedurale e komunikimit diplomatik, me palën ankuese nuk është bërë nga përmbauesja private dhe as nuk është tentuar, edhe pse me nenin 18 të LPP-së, është përcaktuar se për dërgimin e shkresave të palëve në procedurë, vlejnë dispozitat e LPK-së, e që në këtë rast përmbauesja private nuk e ka zbatuar nenin 287 të LPK-së, i cili përcakton se: *“Po që se me kontratë ndërkombëtare nuk është përcaktuar ndryshe, lutjet e gjykatave të vendit për ndihmë juridike u dërgohen gjykatave të huaja në rrugë diplomatike. Lutjet dhe shkresat tjera që i bashkëngjiten duhet të hartohen në gjuhën e shtetit të lutur, ose duhet t’u bashkëngjitet përkthimi i tyre i legalizuar në atë gjuhë”*.

Komisioni vlerëson se shkelja e tretë e përmbaueses private në këtë rast, është me rastin e vlerësimit nga ana e përmbaueses se dërgimi është bërë në mënyrë të rregullt, kur ju ka dorëzuar urdhri përmbaueses private dhëndrit të palës ankuese me datë 27.12.2019, sepse në këtë rast fillimisht nuk dihet si kontaktoi përmbauesja apo pse ju dërgua urdhri dhëndrit të palës ankuese, kur në shkresat e lëndës nuk ka autorizim që e përfaqëson palën ankuese, nuk ka adresë të dhëndrit të palës ankuese, madje adresa nuk është paraqitur as në fletë dërgesë nga ana e përmbaueses private. Andaj, përmbauesja private me mënyrën se si e ka dërguar urdhrin, i ka bërë dëm palës ankuese, sepse përmbauesja private ka ndërmarr veprime përmbaueses private, duke e caktuar edhe seancën e parë të ankandit publik për shitje, pa qenë e njoftuar fare pala ankuese. Ndërsa, në anën tjetër pranuesi i urdhrit, dhëndëri i palës ankuese me parashtrësën e datës 30.12.2019, apo tri ditë pas pranimit të urdhrit, ia ka kthyer përmbaueses urdhrin origjinal në zyren e saj, duke e mohuar se është dhëndri i palës ankuese, e në anën tjetër përmbauesja private, nuk e ka ndërmarrë asnjë kundërveprim lidhur me procedurën që ka qenë duke e zhvilluar, pasi që pala ankuese-debitori nuk ishte njoftuar me urdhrin përmbaueses private. Prandaj pretendimi i përmbaueses se janë plotësuar kushtet ligjore të dërgimit të shkresave nga neni 111 i LPK-së, janë të paqëndrueshme, ngase është e qëndrueshme se edhe fqinjët mund t’i pranojnë shkresat në kushtet e përcaktuara ligjore, por në këtë rast pranimi i shkresave nga dhëndri i palës ankuese, nuk dihet në asnjë rrethanë nga shkresat e lëndës se si është bërë. Andaj, për këto arsye komisioni vlerëson se në këtë rast përmbauesja private ka bërë vlerësim të gabuar kur ka konstatuar se në mënyrë të rregullt është njoftuar pala ankuese me veprimet përmbaueses private të saj.

#### *Baza juridike shkeljes disiplinore.*

Në këtë rast siç shihet nga konstatimet dhe vlerësimet e bëra si më lart, komisioni erdhi në përfundim se përmbauesja private ka bërë shkelje disiplinore nga neni 367, paragrafi 1, nën paragrafi 2 i LPP-së, i cili përcakton se: *“Nëse gjatë kryerjes së veprimeve në kuadër të aktivitetit*

*të tij përmbaruesi privat nuk i përmbahet ligjit”, që në këtë rast përmbaruesja private nuk iu ka përmbajtur ligjit për komunikim me palën në procedurë siç është në këtë rast pala ankuese, por ka ndër marrë veprime përmbarimore siç u vlerësua më lart, pa pasur prova shkresore se debitori-pala ankuese se ka qenë në dijeni se është duke u zhvilluar një procedurë përmbarimore ndaj tij.*

*Historiati i shkeljeve disiplinore nga përmbaruesja private.*

Përmbaruesja private në këtë rast është emëruar me vendimin e Ministrisë së Drejtësisë, me numër 67/2016 i datës 04.07.2016, ndërsa ushtrimin e veprimtarisë përmbaruese e ka filluar me datë 12.08.2016, sipas vendimit të nxjerrë nga Ministria e Drejtësisë, me numër 08-2422/7 më datën 10.08.2016.

Me vendimin, nr. 01/2019 të datës 15.03.2019, të Komisionit Disiplinor për Përmbarues Privat, përmbaruesja private ka bërë shkelje disiplinore nga neni 367 par.1 pikat 1.1, 1.2 dhe 1.7 të LPP-së, si dhe nga neni 5 i Udhëzimit Administrativ MD.nr.06/2014, për Tarifat për Shpërblim dhe Kompensimin e Përmbaruesve Privat dhe iu është shqiptuar masa disiplinore vërejtje, bazuar në nenin 368 , paragrafi 1.1 i LPP-së.

Me vendimin, nr. 04/2020 të datës 23.06.2020, të Komisionit Disiplinor për Përmbarues Privat, përmbaruesja private ka bërë shkelje disiplinore nga neni 367 par.1 pikat 1.1, 1.2 të LPP-së, dhe iu është shqiptuar masa disiplinore gjobë në lartësi prej 1000.00 euro, bazuar në nenin 368 paragrafi 1.1 dhe 1.3 të LPP-së.

Me vendimin, me nr. 53/2021 i datës 21.12.2021, të Komisionit Disiplinor për Përmbarues Privat, përmbaruesja private ka bërë shkelje disiplinore nga neni 367 par.1 pika 1.3 të LPP-së, dhe iu është shqiptuar masa disiplinore gjobë në lartësi prej 1000.00 euro, bazuar në nenin 368 paragrafi 1.1 dhe 1.3 të LPP-së.

Me vendimin, me nr. 59/2021 i datës 28.01.2022, të Komisionit Disiplinor për Përmbarues Privat, përmbaruesja private ka bërë shkelje disiplinore nga neni 367 par.1 pika 1.2 të LPP-së, dhe iu është shqiptuar masa disiplinore ndalim i ushtrimit të profesionit për një periudhë kohore për tre (3) muaj, bazuar në nenin 368 paragrafi 1.1 dhe 1.4 të LPP-së.

Komisioni Disiplinor për Përmbarues Privat, me rastin e shqiptimit të masës si në dispozitiv të këtij vendimi mori për bazë të gjitha rrethanat të cilat mund të ndikojnë në llojin e masës dhe atë posaçërisht peshën dhe pasojat e shkeljeve, dëmin e shkaktuar, shkallën e përgjegjësisë dhe masat e mëhershme disiplinore, siç përcaktohet me nenin 368 paragrafi 4 i LPP-së, dhe duke u bazuar në arsyet e dhëna më lart vendosi që përmbarueses private t’i shqiptohet masa disiplinore shkarkim nga detyra, në bazë të nenit 368 paragrafi 1 nën paragrafi 5 i LPP-së, për shkeljet e konstatuara në



këtë rast lëndor, sepse çdo masë tjetër ndaj përmbaueses private në të kaluarën siç janë theksuar më lart, kanë qenë pa ndikim në përmirësimin e shërbimeve të përmbaimit nga ana e përmbaueses private, andaj komisioni vlerësoi se çdo masë tjetër përveç asaj mase të shqiptuar në dispozitiv të këtij vendimi do të ishte pa ndikim tek përmbauesja private për përmirësimin e veprimeve të përmbaimit.

Komisioni Disiplinor për Përmbaues Privat, me rastin e vendosjes mori parasysht edhe pretendimet e përmbaues private se ankesa-kërkesa e palës ankuese është parashkruar pasi që kanë kaluar më shumë se një vit nga dita kur pretendohet se është bërë shkelja, siç përcaktohet me nenin 375 të LPP-së, ngase pretendohet se shkelja është bërë me datë 27.12.2019, ndërsa iniciimi i procedurës është bërë me datë 21.04.2022. Ky pretendim i përmbaueses private është vlerësuar nga komisioni si i paqëndrueshëm dhe pa ndikim për të vendosur ndryshe, sepse nga shkresat e lëndës me asnjë provë shkresore nuk mund të vërtetohet se pala ankuese ka qenë e njoftuar me ndërmarrjen e veprimeve përmbaimore nga ana e përmbaueses private derisa pala ankuese ka ardhur në Kosovë dhe ka shkuar në komunë me datë 30.03.2022, për ta nxjerrë listën poseduese të paluajtshmërisë së tij, dhe me atë rast është njoftuar se është duke u zhvilluar një procedurë përmbaimore ndaj tij. Me këtë rast komisioni vlerësoi se nuk kemi parashkrim të kërkesës sepse pala ankuese ka rënë në dijeni me datë 30.03.2022, e jo me datë 27.12.2019, dita kur janë marrë veprimet përmbaimore. Për më tepër në këtë rast nuk kemi parashkrim të iniciimit të procedurës sepse me rastin e veprimit të fundit të ndërmarra me shkelje ligjore nga ana e përmbaueses private, është ndërmarrë veprim me konkluzionin për shitje P.nr.826/2019 me datën 04.11.2021, me të cilin është caktuar ankandi publik me datën 06.12.2021, e që bazuar në veprimet e fundit të ndërmarra nga përmbauesja në këtë lëndë, nuk kanë kaluar as 6 muaj, nga dita e iniciimit të procedurës disiplinore nga pala ankuese, edhe për këto arsye pretendimi i përmbaueses private se kemi parashkrim të kërkesës, është i paqëndrueshëm.

Nga sa u tha më lartë, Komisioni vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi bazuar në dispozitat ligjore 361 paragrafi 2 lidhur me nenin 374 të LPP-së.

**KOMISIONI DISIPLINOR PËR PËRMBAUESIT PRIVAT**  
**DPL.nr 12/2022 datë 14.07.2022**

**Kryesuese e Komisionit Disiplinor**  
**Manushe Karaçi**



**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij vendimi pala e pakëndësuar ka të drejtë të hap konflikt administrative bazuar në nenin 374 par 5 të LPP-së.